



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.631/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada Gllogjani kryesuese, Kymete Kicaj dhe Adnan Konushevcu anëtarë. duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor në afërsi të vendvotimit, për Zgjedhjet Lokale 2021, që janë mbajtur më datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.10. 2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.631/2021 e datës 17.10.2021, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit.

A r s y e t i m

Më datë 17.10.2021 subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Vitisë përkatësisht kandidati për kryetar të Komunës nga ky subjekt Alush Ademi ka vendosur poster/baner në afërsi prej 20m nga vendvotimi, gjegjësisht shkollën që gjendet përball.

Si dëshmi ankesës ia ka bashkangjitur edhe dy fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 17.10.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje thekson se ankesa është e pabazuar për faktin se e njëjta nuk dëshmon se për cilën qendër të votimit bëhet fjalë se në cilin fshat apo lagje ka ndodhur shkelja. Edhe sikur të ishin të sqaruara këto rrethana, parashtruesi i ankesës ka dështuar të dëshmojë se në cilën datë dhe në çfarë kohe ka ndodhur kjo. Po ashtu Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka asnjë kandidat për kryetar komune me emrin Alush Ademi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas vlerësimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, e paraqitur për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, është e pa bazuar. Në rastin konkret subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, pretendimet e bëra në ankesë nuk ka arritur ti mbështes me prova të mjaftueshme që do të dëshmonin se pretendimet e tyre janë të bazuara. Në ankesën e tyre si provë kanë bashkëngjitur fotografi të printuara, por të njëjtat nuk dëshmojnë se për cilën shkollë apo vendvotim bëhet fjalë, në cilin vend është vendvotimi e as në cilën kohë është vendosur posteri.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht nenit 36, pasi që ankesa e parashtuesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.631/2021 më datën 18.10.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.1 të LZP-së.